



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 31010- 01541-8-2016 (12305)Rregj.Them.

Nr. 1299 (86-2016-2712)Vendimi

Datë Regjistrimi 07.04.2016

Datë 24.05.2016

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA

GJYQTAR - Altina NASUFI

GJYQTAR - Bernina KONDI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Valbona Zenelaj në Tiranë, sot më datë 24.05.2016, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

- PADITËSE:** Shoqëria "Gjoni" Sh.p.k. me seli në adresën: Lezhë, ish-N. Ndërtimit.
- TË PADITUR:** Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë.
- OBJEKTI:** Shfuqizimin e Aktit Administrativ, Njoftim Vlerësimit Tatimor Nr. 2840/3, datë 30.05.2014, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Lezhë dhe vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë Nr. 17645/1 datë 25.09.2014.
- BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 42, K.Pr.Civile Neni 153 e vijues; K.Pr.Administrative, nenet 9, 11, 14, 18, 116, 117, 118; ligji nr.49/2012, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", Neni 15 e vijues. Ligji Nr.9920, dt. 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore". Ligji 7928 dat 27.04.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar". Udhëzimi Nr.17 datë 13.05.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". Nenet 31, 32, 102, 324 e vijues të K.Pr.Civile. Nenet 105, 137 e vijues të K.Pr.Administrative.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në përfundim të gjykimit të çështjes me vendimin nr. 603, datë 08.07.2015 ka vendosur:

1. "Rrëzimin e kërkesë padisë.
1. Shpenzimet gjyqësore sic janë bërë".



Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ka paraqitur ankim pala paditëse.

Pala e paditëse në ankimin e paraqitur prej saj ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duke parashtruar se:

1. Bazuar në ligjin nr. 9920/2008 çdo gabim apo pasaktësi në plotësimin e faturës tatimore është përgjegjësi e shitësit dhe jo e blerësit sikurse gabimisht trajtohet nga DRT Lezhë, pasi blerësi vetëm firmos faturën dhe merr një kopje të saj.
2. Subjektet "Agbest" shpk dhe "O+P" shpk kanë lëshuar fatura tatimore për shërbimet që ato kanë kryer, të cilat janë likuiduar dhe deklaruar në kohë nga ana e firmës "Gjoni" shpk.
3. Nuk është përgjegjësi e palës paditëse për mbajtjen në rregull të dokumentacionit financiar të një shoqërie tjetër sic janë dy shoqëritë "Agbest" shpk dhe "O+P" shpk.
4. Arsyetimi i gjykatës se në rastin konkret është zbatuar procedura nga pala e paditur është e pabazuar pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me një rikontroll të DRT Lezhë dhe jo një vizitë fiskale. Në rastin e rikontrollit duhet miratimi i DPT-së referuar nenit 85 të ligjit nr. 9920/2008.
5. Në rastin konkret gjykata ka gabuar kur e ka cilësuar të ligjshëm kontrollin e bërë nga DRT Lezhë pranë palës paditëse, pasi është cilësuar gabimisht vizitë fiskale, por në fakt ka qenë rikontroll.
6. Argumentimi i palës së paditur se faturat janë fiktive në shkresën nr. 8479, datë 08.04.2011 është i gabuar pasi nuk është përgjegjësi e blerësit mosdeklarimi i faturave nga shitësi, dhe blerësi i ka deklaruar në kohë këto fatura e konkretisht brenda datës 20 të muajit Maj dhe Qershor 2011.
7. Shoqëria paditëse është kontrolluar dy herë të tjera për këtë periudhë në datat 04.08.2011 dhe 15.01.2014 dhe ka dalë korrekt edhe sa i takon faturave të blerjes. Pala paditëse ka rreth 30 furnitorë kryesorë të cilët kanë deklaruar me korrektesë faturat e tyre, por pala paditëse nuk mund të kontrollojë nëse furnitorët janë korrekt me deklaratimet e faturave të shitjes.
8. Ligji nr. 7928/1995 "Për TVSH" është shfuqizuar dhe nga data 01.01.2015 ka hyrë në fuqi ligji nr. 92/2014 "Për TVSH", por ky argument nuk u mor parasysh nga gjykata, e cila vlerësoi se ligji nr. 7928/1995 ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së shkeljes administrative.

Sa sipër pala paditëse kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe pranimin e padisë sipas objektit të saj.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoi relacionin e për gatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankim, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

VËREN

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër në datën 22.10.2014 me kërkesë padi duke kërkuar:

Shfuqizimin e Aktit Administrativ, Njoftim Vlerësimit Tatimor Nr. 2840/3, datë 30.05.2014, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Lezhë dhe vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë Nr. 17645/1 datë 25.09.2014.

Pala paditëse në lidhje me këto kërtime ka referuar si bazë ligjore në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë neni 42, K. Pr. Civile nenin 153 e vijues; K. Pr. Administrative, nenet 9, 11, 14, 18, 116, 117, 118; ligji nr. 49/2012, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", Neni 15 e vijues. Ligji Nr. 9920, dt. 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore". Ligji 7928 datë 27.04.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar". Udhëzimi Nr. 17 datë 13.05.2008 "për tatimin mbi vlerën e shtuar". Nenet 31, 32, 102, 324 e vijues të K. Pr. Civile. Nenet 105, 137 e vijues të K. Pr. Administrative.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në përfundim të gjyimit të çështjes me vendimin nr. 603, datë 08.07.2015 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë padisë.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka paraqitur ankim në datën 22.07.2015 pala paditëse.

Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtij ankimi në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 603, datë 08.07.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër rezulton se:

Shoqëria "Gjoni" shpk është një shoqëri e së drejtës shqiptare që ushtron aktivitet ekonomik me objekt në fushën e ndërtimit dhe të tregtisë referuar ekstraktit të saj të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Pranë palës paditëse, është ushtruar një vizitë fiskale, sipas njoftimit nr. 2840, datë 02.05.2014 dhe programit përkatës nga ana e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë (DRT Lezhë) me objekt: Verifikimin e saktësisë së deklaramit për transaksionet e kryera nga shoqëria "Agbest" shpk dhe shoqëria "O+P" shpk, të lëshuara për palën paditëse, të cilat kjo e fundit i ka paraqitur të kreditueshme në librat e blerjeve për periudhën tatimore Maj-Qershor 2011.

Në përfundim të kontrollit (vizitë fiskale), shoqëria "Gjoni" shpk është njoftuar për aktin administrativ (Raportin e kontrollit dhe Njoftimin e Vlerësimit) Nr. 2840/3, datë 30.05.2014 të DRT Lezhë për një detyrim në vlerën 540.742 lekë, cili përbëhej nga:

Tatim Fitim	57.449 lek
T.V.SH	159.151 lek
Interesa	64.283 lek
Gjobë 100%	259.859 lek
Totali	540.742 lek

Sipas Akt- kontrollit ky detyrim lind si rezultat se, faturat tatimore të lëshuar nga shoqëria "AGBEST" shpk dhe "O+P" shpk, janë tre fatura blerje me TVSH të zbritshme (të kreditueshme), të lëshuara nga subjekti "Agbes", Fier me Nipt J82916421N dhe shoqëria "O+P" Fier me Nipt K13408401J si me poshtë:

- Fatura nr.79, datë 03.05.2011 (seria nr.42614179) me vlerë të tatueshme 245,000 lekë me TVSH 49,000 Leke (Inerte)
- Fatura nr.99, datë 21.05.2011 (seria nr.42614099) me vlerë të tatueshme 245,000 leke me TVSH 49,000 Leke (Inerte).

Fatura nr.50, datë 20.06.2011 (seria nr.42614099) me vlerë të tatueshme 232,000 leke me TVSH 46,400 Leke (Inerte).



Referuar shkresës nr. 8479 Prot. Datë 08.04.2014 të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, specifikohet se faturat e lartpërmendura janë fiktive dhe nuk plotësojnë kushtet e kreditimit të TVSH, pasi këto fatura nuk janë tërhequr nga subjektet shitës nga Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse dhe nuk janë deklaruar as në shitje nga ana e tyre.


Në këto rrethana bazuar në ligjin nr. 7928, "Për TVSH", ligjin 8438 "Për tatimin mbi të ardhurat, nuk i njihen faturat e sipërpërmendura në blerje, dhe për rrjedhojë nuk i njihet kreditimi i TVSH-së së zbritshme duke e dënuar shoqërinë "Gjoni" sh.p.k me gjobë 100% të detyrimit tatimor.

Shoqëria "Gjoni" sh.p.k. ka ndjekur rrugën administrative, sipas ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore", duke e ankimuar në Drejtorinë e Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DAT Tiranë).

Drejtoria e Apelit Tatimor pasi ka shqyrtuar ankimin e palës paditëse me vendimin nr. 17645/1, datë 25.09.2014, ka njoftuar palën paditëse se ka vendosur lënien në fuqi të Aktit Administrativ nr 2840/3, datë 30.05.2014, për shumën 540.742 leke, të lëshuar nga DRT Lezhë.

Në vendimin e saj DAT Tiranë ka argumentuar se:

1. Nga kontrolli i dokumentacionit që shoqëria "Gjoni" shpk dispononte dhe që janë vënë në dispozicion të inspektorit të kontrollit ka rezultuar se janë tre fatura blerje me TVSH të zbritshme të kreditueshme e konkretisht fatura nr. 79, datë 03.05.2011, fatura nr. 99, datë 21.05.2011, fatura nr.50, datë 20.06.2011.
2. Referuar shkresës nr. 8479 Prot. Date 08.04.2014 të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, specifikohet se faturat e lartë përmendura janë fiktive dhe nuk plotësojnë kushtet e kreditimit të TVSH, pasi këto fatura nuk janë tërhequr nga subjektet shitës nga Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse dhe nuk janë deklaruar as në shitje nga ana e tyre.
3. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 7928/1995 "Për TVSH" dhe të udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008 "Për TVSH" kreditimi i TVSH-së është një e drejtë, e cila fitohet vetëm nëse tatimpaguesi plotëson kushtet si vijon: furnizimet të jenë kryer realisht; furnizimet e marra t'i shërbejnë furnizimeve të tatueshme të shoqërisë; furnizimet të jenë dokumentuar me origjinalin e faturës tatimore; fatura tatimore nëpërmjet së cilës dokumentohet furnizimi të jetë e plotësuar saktë me të gjithë elementët e përcaktuar në nenin 36 të ligjit nr. 7928.
4. Një ndër elementët kryesorë për të përfituar të drejtën e kreditimit është dokumentacioni mbi të cilin mbështetet kreditimi e konkretisht fatura tatimore. Mungesa apo mangësitë në plotësimin e elementëve të saj pasjellin humbjen e të drejtës për të përfituar kreditimin e tatimit.
5. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur ankimit, konstatohet se faturat në lidhje me të cilat është kryer vlerësimi tatimor kanë mangësi në elementët e domosdoshëm që duhet të përmbajë një faturë tatimore. Ato nuk përmbajnë të dhëna si ora e kryerjes së furnizimit, emri dhe nënshkrimi i shitësit dhe transportuesit, targa e mjetit të transportit është e njëjtë për të dyja shoqëritë "Agbes" dhe "O+P" e për më tepër nga Drejtoria e Hetimit Tatimor është konstatuar se faturat e lëshuara nga këto dy shoqëri nuk janë



derhequr prej tyre nga DRT Fier dhe nuk janë deklaruar në librat e shitjes së këtyre shoqërive.

6. Referuar të dhënave të aktivitetit të këtyre dy shoqërive sipas ekstraktit të QKR-së konstatohet se objekti i të dhënave të aktivitetit të këtyre shoqërive nuk përputhet me mallrat e blera nëpërmjet faturave tatimore, objekt vlerësimi tatimor.
7. Mungesa e plotësimit të elementëve të këtyre faturave tatimore shoqëruar me mosmarrjen e faturave tatimore nga shoqëritë shitëse pranë organeve tatimore, mosdeklarimi i tyre pranë organit tatimor, si dhe mospërputhja e objektit të veprimtarisë së shoqërive me mallrat që përshkruhen në fatura, janë shkak i arsyeshëm për fillimin e procedurave hetimore paraprake në lidhje me vërtetësinë e faturave.
8. Drejtoria e Hetimit Tatimor ka arritur në konkluzionin se këto fatura janë fiktive. Pra pavarësisht parashtrimeve për likuidimin apo saktësinë e faturave arrihet në përfundimin se fatura tatimore nuk krijon bindjen për kryerjen reale të furnizimeve të pretenduara.

Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër në datën 22.10.2014 me kërkesë padinë me objekt, palë të paditur dhe bazë ligjore siç përcaktohet në pjesën hyrëse të këtij relacioni.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në përfundim të gjykimit të çështjes me vendimin nr. 603, datë 08.07.2015 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë padisë.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 603, datë 08.07.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër rezulton se:

1. Gjykata vlerëson se duhet ti referohemi ligjit të kreditimit dhe udhëzimeve përkatëse për efekt të legjislacionit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes konkrete, e konkretisht Ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për TVSH" Udhëzimi Nr. 17, Datë 13.05.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" i ndryshuar paragrafi 18 përkufizon kreditimin e TVSH-së si dhe kushtet dhe procedurat e regjistrimit të faturave, që duhet të zbatohen nga tatimpaguesi me qëllim përfitimin dhe kreditimin e tatimit të paguar në blerje.
2. Në vijim të këtyre rregullave, ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për TVSH" neni 36 pika 1 dhe pika 2 dhe paragrafi 11.1 i Udhëzimi Nr. 17 Datë 13.05.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" i ndryshuar përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e faturës tatimore (elementet e domosdoshëm që duhet të mbajë fatura). Në qoftë se fatura nuk përmban të dhënat e përcaktuar më lart, blerësi nuk ka të drejtë që të kreditojë ose zbresë TVSH-në.
3. Në zbatim të dispozitave të mësipërme e drejta për kreditim të TVSH-së është një e drejtë e cila fitohet vetëm nëse tatimpaguesi ka plotësuar kushtet e sipërpërmendura, për pasojë dokumenti i furnizimit nëpërmjet faturës tatimore nuk kërkon vetëm ekzistencën fizike të saj, por kjo faturë duhet të përmbajë të gjitha elementët e saj. Pra elementët kryesore për të përfituar të drejtën e kreditimit, është dokumenti mbi të cilin mbështetet ky kreditim, konkretisht fatura tatimore. Mungesa e saj ose mangësitë në plotësimin e elementeve të saj, sjellin humbjen e së drejtës së kreditimit të saj. Nga rasti në gjykim rezulton se: Fatura nr. 79, datë 03.05.2011, fatura nr. 99 datë 21.05.2011, fatura nr. 50, datë 20.06.2011.
4. Kanë mangësi në elementët e domosdoshëm që duhet të përmbajë një faturë tatimore. Ato nuk përmbajnë të dhëna si ora e kryerjes së furnizimit, emrin dhe nënshkrimin e shitësit dhe të transportuesit, nuk kanë të cilësuar targën e mjetit me të cilin do të

transportohet malli. Në të dyja subjektet është i njëjti fenomen. Subjektet shitëse nuk kanë deklaruar në organin tatimore këto fatura tatimore si shitje. Dhe se nga ana e subjekteve shitëse faturat tatimore të mësipërme të pretenduara nuk janë tërhequr nga Drejtoria Tatimore, si kusht i domosdoshëm për të disponuar me faturë tatimore për rimbursim.

5. Rezulton se të dyja subjektet nuk kanë si aktivitet mallrat e pretenduara si të blera nëpërmjet faturave tatimore, objekt i vlerësimit tatimor.
6. Për sa i përket pretendimit të paditësit se shoqëria Gjoni shpk është kontrolluar edhe dy herë të tjera për këtë periudhë respektivisht me datë 04.08.2011 dhe 15.01.2014 dhe ka rezultuar korrekt, provohet se kontrolli tatimor është bërë me program kontrollin nr. 2840 Prot. Datë 02.05.2014, në vijimësi të shkresës nr. 4879, datë 08.04.2014 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve pas një konstatimi të bërë nga Drejtoria e Hetimit Tatimor ndaj një serë subjektsh Tatimpaguese, për fatura tatimore shitje –blerje të realizuara me subjekte tatimore "Agbest" shpk dhe "O+P" shpk, ku në listë është dhe paditësi shoqëria "Gjoni" shpk për tre faturat tatimore të sipërcituara.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kanë bërë ankim palët e paditura për shkaqet e paraqitura sa më lart.

Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, të akteve të dosjes, të vendimit objekt ankimi si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit material dhe procedural që gjen zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Vendimi nr. 603, datë 08.07.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjit procedural dhe material dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Gjykata çmon se, detyrimi tatimor dhe gjoba në shumën prej 540,742 lekë i përcaktuar në Njoftim Vlerësimit Tatimor Nr. 2840/3, datë 30.05.2014 të DRT Lezhë është nxjerrë në përputhje me ligjin.

Ky detyrim lind si rezultat se, faturat tatimore të lëshuar nga shoqëria "AGBEST" shpk dhe "O+P" shpk janë fatura fiktive. Konkretisht, ka rezultuar se janë tre fatura blerje me TVSH të zbritshmi (Të Kreditueshme), të lëshuara nga subjekti "Agbes", Fier me Nipt J82916421N dhe shoqëria "O+P" Fier me Nipt K13408401J si me poshtë:

- Fatura nr.79, datë 03.05.2011 (seria nr.42614179) me vlerë të tatueshme 245,000 lekë me TVSH 49,000 Lekë (Inerte)
- Fatura nr.99, datë 21.05.2011 (seria nr.42614099) me vlerë të tatueshme 245,000 leke me TVSH 49,000 Lekë (Inerte).
- Fatura nr.50, datë 20.06.2011 (seria nr.42614099) me vlerë të tatueshme 232,000 lekë me TVSH 46,400 Lekë (Inerte).

Referuar shkresës nr. 8479 Prot. Date 08.04.2014 të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, specifikohet se faturat e lartpërmendura janë fiktive dhe nuk plotësojnë kushtet e kreditimit të TVSH, pasi këto fatura nuk janë tërhequr nga subjektet shitës nga Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse dhe nuk janë deklaruar as në shitje nga ana e tyre.

Në lidhje me këtë fakt pala paditëse në ankimin e ngritur prej saj ka pretenduar se bazuar në ligjin nr. 9920/2008 çdo gabim apo pasaktësi në plotësimin e faturës tatimore është

deliberations

Gjykata Administrative e Apelit, çmon se ky pretendim i palës paditëse është i pabazuar në ligj e në prova dhe si i tillë është i papranueshëm.

Pala paditëse këto fatura i ka përdorur për të kredituar TVSH-në bazuar në ligjin nr. 7928/1995 "Për TVSH". Ky ligj përcakton se një ndër kushtet kryesore të aplikimit për të kredituar TVSH nga subjekti tatimpagues është paraqitja e faturës së TVSH-së si i vetmi dokument zyrtar që shërben për të provuar transaksionin financiar të kryer ndërmjet dy subjekteve tatimpaguese. Për këtë shkak pala paditëse ka përgjegjësinë e saj për saktësinë e faturave tatimore të provuar se mallrat e blera nga ajo me faturat nr. 50, nr. 79, nr. 99, me të cilat ka aplikuar për kreditimin e TVSH-së janë blerë për qëllim të aktivitetit tregtar të shoqërisë dhe jo për qëllime të tjera.

Në këtë këndvështrim, pala paditëse në cilësinë e palës blerëse ka detyrimin të provojë saktësinë e të dhënave të pasqyruara në faturat tatimore tatimore nr. 50, nr. 79, nr. 99.

Gjykata çmon se, se me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë me të drejtë ka vlerësuar se në rastin konkret në këto tre fatuara janë listuar mallra të cilat nuk kanë lidhje me aktivitetin tregtar të palës paditëse, si dhe kjo e fundit nuk arriti të provojë gjatë gjykimit të çështjes se këto mallra i kanë shërbyer aktivitetit të saj tregtar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7928/1995 "Për TVSH".

Në këto rrethana bazuar në ligjin nr. 7928, "Për TVSH", ligjin 8438 "Për tatimin mbi të ardhurat, nuk i njihen faturat e sipërpërmendura në blerje, dhe për rrjedhojë nuk i njihet kreditimi i TVSH-së së zbritshme duke e dënuar shoqërinë "Gjoni" sh.p.k me gjobë 100% të detyrimit tatimor.

Në lidhje me pretendimin e palës së paditur se procedura e kontrollit e ndjekur nga pala e paditur në rastin konkret është në kundërshtim me ligjin dhe se gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur e ka cilësuar të ligjshëm kontrollin e bërë nga DRT Lezhë pranë palës paditëse, pasi është cilësuar gabimisht vizitë fiskale, por në fakt ka qenë rikontroll, Gjykata cmon se është i pabazuar në ligj e në prova dhe si i tillë është i papranueshëm.

Gjykata çmon se, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kontrolli i llojit “vizitë fiskale” është kryer nga pala e paditur në përputhje me procedurën ligjore të përcaktuar në ligjin nr. 9920/2008.

Konkretisht, kontrolli tatimor është bërë me program kontrollin nr. 2840 Prot. Datë 02.05.2014, në vijimësi të shkresës nr. 4879, datë 08.04.2014 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve pas një konstatimi të bërë nga Drejtoria e Hetimit Tatimor ndaj një serë subjektesh Tatimpaguese, për fatura tatimore shitje-blerje të realizuara me subjektet tatimore "Agbest" shpk dhe "O+P" shpk, ku në listë është dhe paditësi shoqëria "Gjoni" shpk për tre faturat tatimore të sipërcituara (nr. 50, nr. 79, nr. 99).

Referuar shkresës nr. 8479 Prot. Datë 08.04.2014 të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, specifikohet se faturat e lartpërmendura janë fiktive dhe nuk plotësojnë kushtet e kreditimit të TVSH, pasi këto fatura nuk janë tërhequr nga subjektet shitës nga Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse dhe nuk janë deklaruar as në shitje nga ana e tyre

Në konkluzion të sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit çmon se, pretendimi i palës paditëse-ankuese i paraqitur në ankimin e saj përpara Gjykatës për shfuqizimin e aktit administrativ, Njoftim Vlerësimit Tatimor Nr. 2840/3, datë 30.05.2014, të Drejtorisë

Rajonale të Tatimeve Lezhë dhe vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë Nr. 17645/1, datë 25.09.2014, është një pretendim i pabazuar në ligj e në prova.

Në rrethanat e përshkruara sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", çmon se vendimi nr. 603, datë 08.07.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*,

VENDOSI :

1. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 603, datë 08.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
2. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 24.05.2016.

GJYQTAR
Bernina KONDI
d.v

GJYQTAR
Altina NASUFI
d.v

GJYQTAR
Kastriot SELITA
d.v

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelari
Leonard Stani
[Signature]